



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:003785

Datë: 16.02.2024

Numri i dokumentit: 05340608

Ac.nr.127/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Naime Ahmeti, kryetare e kolegjit, Halide Reka dhe Adnan Konushevci, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.G., nga Ferizaji, Rr.”B..... A.....”, nr.XX, të cilin me autorizim e përfaqëson B.Rr., avokat nga Ferizaji, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi juridik S.V., në çështjen juridike lirim i pronës, duke vendosur sipas ankesës të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.71/2020 të datës 19.11.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 06.02.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohet e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Ferizajt - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, prishet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.71/2020 i datës 19.11.2020, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.71/2020 të datës 19.11.2020, nën pikën një të dispozitivit ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.G., kundër të paditurës Komuna e Ferizajt-Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm. Në pikën dy ka detyruar të paditurën që ta liroj nga sendet hapësirën me sipërfaqe prej 1500 m², në ngastrën kadastrale XXX-X Zona Kadastrale në Ferizaj lidhur me koordinatat siç përshkruhen në Pëlqimin Ref: KE:XX/XX të datës 03 korrik 2019, të dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural-Agjencia Pyjore e Kosovës. Në pikën tre është detyruar e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t’i paguaj paditësit shumën prej 620 € (gjashtëqind e njëzetë euro) në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Në pikën katër është refuzuar kërkesa e paditësit për kompensim dëmi për fitim të humbur, pasi që i autorizuari i paditësit, në seancën e shqyrtimit kryesor është tërhequr nga kjo pjesë e kërkesëpadisë.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit, ta aprovoj ankesën të bazuar, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta prish dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, apo i njëjti të ndryshohet dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet e pabazuar.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit në përgjigje në ankesë ka propozuar që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi N.G., ka ushtruar padi më datë 14.01.2020, kundër të paditurës Komuna e Ferizajt - Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura ta lirojë hapësirën në ngastrën XXX-X, në sipërfaqe prej 1500 m², Zona Kadastrale në Ferizaj, në koordinatat si në Pëlqim dhe kopje të planit me numër Ref: KE:XXX/XX të datës 03 korrik 2019, të lëshuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore e Kosovës.

E paditura përmes përgjegjës në padi të datës 01.06.2020, e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se paditësi posedon vetëm një pëlqim lëshuar nga MBPZHR, për lejin e ndërrimit të destinimit të përkohshëm për marrjen në shfrytëzim të tokës pyjore me qira për ngritjen e objektit, ndërsa paditësi nuk ka marrëdhënie kontraktuale, andaj i mungon legjitimiteti me penë palë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka zhvilluar procedurën gjyqësore dhe pas administrimit të provave shkresore si: Pëlqim nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Agjencia Pyjore Kosovës me nr.Ref:KE:XXX/XX e datës 03.07.2019, Formulari për Kërkesë apo Ankesë i datës 30.08.2019 i bërë nga paditësi drejtuar të paditurës, Certifikata e Pronësisë me nr. XXXX-2019 e datës 29.08.2019, Informatë e lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Mjedise - Komuna Ferizaj e datës 30.08.2019, Vendim me nr. 03 i datës 18.07.2011 lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Pronë, Gjeodezi, Kadastër dhe Mjedise - Komuna Ferizaj, Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm, me numër X .Nr.XX i datës 28.07.2011 lëshuar nga Kuvendi i Komunës Ferizaj dhe Ekspertiza Gjeodezike e datës 02.11.2020 e hartuar nga Eksperti Gjeodet M.L., pas vlerësimit të tyre ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar me të cilin e ka aprovuar të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke e detyruar të paditurën që ta liroj nga sendet hapsirën me sipërfaqe prej 1500 m², në ngastrën kadastrale XXX-1 ZK Ferizaj në koordinatat siç përshkruhen në pëlqimin Ref:KE:XXX/19 e datës 03.07.2019, të dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nga administrimi i provave materiale që gjenden në shkresa të lëndës, ka vërtetuar se e paditura ka hyrë në parcelën kontestuese pa bazë juridike, ndërsa paditësit i ishte lejuar të bëjë ndërrimin e destinimit të përkohshëm me qëllim të ndërtimit të objektit me material të përkohshëm. Në këtë kuptim me vendosjen e lojërave nga e paditura në parcelën kontestuese paditësit i është vështirësuar vazhdimi i ndërmarrjeve të veprimeve tjera në drejtim të epilogut eventual sipas atij pëlqimi. Vendimin gjykata nuk e ka bazuar në asnjë dispozitë ligjore, lidhur me shpenzimet e procedurës ka vendosur duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar si të rregullt dhe të bazuar në ligj nuk e përkrah Gjykata e Apelit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) dhe 182.1 lidhur me nenin 160. 3 dhe 4 dhe nenin 2.1 të LPK-së, për të cilin shkak aktgjykimi ankimor u deshtë të priset, dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim.

Aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i paqartë dhe i pa ekzekutueshëm, kjo për faktin se diapozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin, se arsyetimi nuk përmban arsye për faktet vendimtare dhe arsyet e dhëna janë të paqarta dhe kundërthënëse.

Gjykata e Apelit i pranon pretendimet ankimore se nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendja faktike, e cila për pasoj pati edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, nga shkak se, për Gjykatën e Apelit është e paqartë se përderisa gjykata e shkallës së parë në procedurë ka lexuar provat si Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm, me numër 01.Nr.63 e lëshuar nga e paditura me datë 28.07.2011, nga shihet se parcelat me numër 22/1 ZK Ferizaj, është shpallur me interes të përgjithshëm dhe e njëjta evidentohen pasuri shoqërore-Ekonomia Pyjore në Ferizaj, ndërsa në arsyetim të aktgjykimit ankimor nuk e ka përmendur fare këtë fakt, duke qenë se paditësi me padi kërkon lirimin e pjesës së kësaj palujtshmërie në sipërfaqe prej 1500 m², në bazë të Pëlqimit nr.Ref: KE:XXX/19 të datës 03 korrik 2019, të dhënë nga MBPZhR-Agjencia Pyjore e Kosovë, në të cilin në faqen e dytë të tij në pasusin dy është theksuar se: *Ky pëlqim lejon vetëm ndërrimin e destinacionit si dhe jep mundësi OE rregullimin e dokumentacionit përkatës në institucionet tjera dhe kurrësi nuk lejon marrjen e veprimeve në terren pa hyrë në marrëdhënie kontraktuale për qiranë e tokës pyjore me APK, paraprakisht OE duhet të sjell-pajiset me leje ndërtimi nga Komuna e Ferizajit, në mënyrë që të hyhet në marrëdhënie kontraktuale me APK-në*”. Andaj në rastin konkret pëlqimi i dhënë nga APK është vetëm një akt administrativ dhe ka nënkuptuar ndërmarrjen e veprimeve të tjera nga paditësi në mënyrë që të hyhet në marrëdhënie kontraktuale, duke siguruar kushtet dhe veprimet tjera administrative që është dashur t'i ndërmerret me të paditurën në këtë raste, sipas atij pëlqimi, mirëpo duke qenë se palujtshmëria për të cilën kërkohet lirimi, me vendimet e të paditurës është shpallë me interes të përgjithshëm sepse evidentohet pasuri shoqërore dhe sipas ekspertizës së ekspertit gjeodet ka dal se e njëjta menaxhohet nga e paditura sipas destinimit të cilin e ka paraparë me planet e saja urbanistike duke vendosur lodra për rekreacion dhe kubëza për shtigje

për qytetarët e saj, gjykata e shkallës së parë nuk ka dhen asnjë arsyetim dhe nuk është bazuar në asnjë dispozitë ligjore në mënyrë e hyrjes në posedim të paditësit, që pastaj e paditura Komuna Ferizaj t'ia liroj atë palujtshmëri, po ashtu me shkresën Informatë të datës 30.08.2019, lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe mjedise, paditësi është njoftuar se ngastra kadastrale XX-X ZK Ferizaj, është e përfshirë në Planin Zhvillimor Komunal 2017-2025 dhe se është e destinuar pjesërisht për Sport dhe Rekreacion, andaj pa u vërtetuar këto fakte nuk mund të vendoset përfundimisht për kërkesëpadinë e paditësit, nga rezulton se edhe e drejta materiale është zbatuar gabimisht.

Lidhur me lirimimin e palujtshmërisë, gjithashtu ligji Nr. 03/L-154 Për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, në nenin 36 par. 1 rregullon që: *Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit i pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.* Kurse me nenin 93 të parashihet se: *Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi.*

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që në rigjykim t'i evitohet të metat e theksuara si më lartë dhe me prova të cilat gjenden në shkresën të lëndës t'i vërtetohet të gjitha faktet vendimtare që kanë të bëjnë me objektin e kontestit, fillimisht të vërtetohet kompetencën e saj lëndore duke pas për bazë vendimi në bazë të cilit paditësi kërkon lirimimin e palujtshmërisë, i cili për nga përmbajtja e tij është i natyrës administrative, se a janë plotësuar kushtet e përcaktuara me atë vendim, në rrethanat përball vendimeve të marra nga e paditura Komuna Ferizaj a ka kushte për ndrim të destinacionit dhe hyrjes në marrëdhënie kontraktuale me APK-në, baza e kërkesëpadisë së paditësit që është lirim palujtshmërie në raport me të paditurën, kushtet të cilat nevojiten të plotësohen për lirimimin e palujtshmërisë siç është cekur në dispozitën e mësipërme, dhe pasi që të vërtetohet të gjitha këto të vlerësojë edhe legjitimitetin e palëve në procedurë, si kusht i domosdoshëm që pastaj gjykata të lëshohet në veprimet e mëtejme për të vërtetuar gjendjen e fakteve, duke marrë parasysh edhe pretendimet ankimore të paditurës të marrë një vendim të drejtë duke u bazuar në dispozitat e të drejtës materiale, duke e arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme, i cili në pikëpamje formale dhe materiale duhet të jetë në përputhje të plotë me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitave nga nenet 194 dhe 195, paragrafi 1, pika (c), lidhur me nenin 200, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata e Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.127/2021, me datë 06.02.2024

Kryetarja e kolegjit
Naime Ahmeti d.v,